

TOMORR PLANGARICA

PREJ LEXUESIT VIRTUAL TE LEXUESI REAL, PREJ “TEKSTIT TË VEPRËS” TE “TEKSTI I LEXUESIT” – DHE NJË QASJE MË SHUMË DREJT ESEVE KRITIKE TË M. KUTELIT

Abstrakti

Duke u përqendruar në esetë kritike të Mitrush Kutelit, do të synohet të shqyrtohen trajtesat kritike të Kutelit si “tekste të lexuesit”, sipas teorizimeve të tekstit të lexuesit, nocion themelor në brendësi të reflektimeve bashkëkohore në lidhje me aktivitetin krijues të lexuesve.

Përse sërish edhe një qasje drejt “shqyrtimeve kritike” të M. Kutelit?¹

Na duket se ende ato shfaqin “enigma” që lidhen me aspekte të veçanta të ngjizjes e receptimit të tyre, të cilat nxisin në vijimësi riqasje dhe interpretime të mëtejshme.

Janë disa tregues që e motivojnë këtë riqasje, mes të cilëve mund të përmendim:

më së pari, nxit natyrshëm interpretim jetëgjatësia e tyre në raport me lexuesin, edhe pse ato, në pamje të parë, janë metatekste, e si të tilla, do të ishin natyrshëm më “jetëshkurtra” (ndryshe nga tekstet letrare, jetëgjatësia e të cilave u nënshtrohet të tjerave ligjësive);

së dyti, mbetet sërish joshëse për shqyrtim natyra e formësimit të tyre si metatekste, por që, si të tilla, i tejkalojnë kufijtë e një diskursi thjesht kritik a shkencor (në to, njëherazi, janë integruar dukshëm tregues të diskursivitetit letrar, duke i vendosur kështu kategoritë tekstore përkatëse mes kufijve);

¹ Natyra e parashtrimeve tona në vijim do të kushtëzohet në formë e paraqitje nga thëniamarrësit e drejtpërdrejtë të këtyre mesazheve, studiues të rinj, në përpunim e sipër të metodologjive të tyre të kërkimit shkencor, të interesuar për njohjen e praktikave të kërkimit, pjesëmarrës e bashkëbisedues në këtë komunikim.

së treti, brendia e tyre ngjizet e formësohet mbi pikëvështrime tejet të sigurta përmes një sistemi konceptesh po ashtu të përvijuar qartë, ndaj analiza dhe shqyrtimi i tyre si dhe pikëvështrimi në analizë e shqyrtim natyrshëm do të duhet të përafrohet me kahje teorike të studimeve të kohës (me cilat? a janë të fundme shpjegimet e dhëna ndërkohë? a lë shkas gjithnjë për interpretime pohimi i autorit i bërë me modesti të skajshme që nuk mëton të jetë “kritik profesionist”?).

Shfaqet, kështu, sërish tërheqës korpusi kritik i Kutelit, përftohen pyetje që kërkojnë vijimisht përgjigje.

Mbi disa pikëvështrime në aspektin epistemologjik

Do të ndjeheshim më të sigurt në qëndrime, nëse do të mbanim parasysh disa parakushte të natyrës epistemologjike që mundësojnë dhe lehtësojnë shqyrtimin e veçantive të këtij objekti studimi, në të cilat të adreson pikërisht vetë ky objekt.

Do të theksonim, më *së pari*, se rezulton më e suksesshme ajo përvojë shqyrtuese që mbështetet në teori a teorizime që parakuptohen dhe kërkohen nga natyra dhe veçantitë e objektit të studimit, sesa ajo që teorisë a teorizimeve u integron mekanikisht në mënyrë ilustrative veçantitë e një objekti studimi (korpusin kritik të Kutelit mund ta vendosim lehtëazi në hapësirën e kritikës letrare, por ndriçimi i profileve të tij të vlerata duhet të depërtojë në një relief të larmishëm e të thyer që karakterizon atë hapësirë; ndaj janë thyerjet e vazhdueshme përballë të cilave gjendet studuesi që duhet ta orientojnë atë drejt kërkimit të mjeteve e metodologjive më të efektshme në studim; dijet, sistemi i koncepteve të përzgjedhura në shqyrtim janë të efektshme, kur përzgjedhja bëhet në ato kahje ku orientojnë tashmë vlerat e përfutuara, në hapësira të veçanta që parakuptojnë po ashtu dije e këndvështrime të veçanta);

së dyti, natyra e tekstit të *studimeve kritike* nxit përgjithësisht përvijimin e një diskursi dekodues, që si i tillë ngjizet me veçantitë e një konteksti të caktuar shkencor a dituror, jetëgjatësia e të cilit nuk është e njëjtë me atë të një teksti letrar, që rivitalizohet në vijimësi nga lexuesi dhe mund të kalojë epoka, duke mbetur gjithnjë tërheqës a joshës (shqyrtimet kritike të Kutelit i kapërcejnë këto ligjësi; natyra e diskurseve të tij kritike përvijohet duke integruar në to tregues të diskursivitetit letrar, duke u vendosur mes hapësirave të ndryshme e kufijve mes tyre, çka orienton një orientim epistemologjik më të ndërlikuar);

së treti, shqyrtimet e tij kritike janë produkt i qëndrimeve të tij si lexues i teksteve letrare, i *lexueshmërisë* së veçantë që synon një produkt,

një ndërmjetësues, për t’i hapur dritare lexuesit të gjerë të veprave letrare përkatëse, për të parë më qartë shijuar e vlerësuar vetë produktet letrare; teoritë e sotme të të lexuarit përftojnë status më të qëndrueshëm të *lexuesit*, në krahasim me ato të mëparshmet, që përqendroheshin në procesin e të lexuarit të tekstit letrar; ato priren jo më thjesht drejt të *lexuarit si proces*, por edhe drejt *individit lexues* në atë proces, jo thjesht në *përshkrimin e procesit*, por më së shumti në shqyrtimin e *produktit të përftuar në atë proces* (edhe “shënimet kritike” të Kutelit mund t’i vështrojmë nga ky pikëvështrim i të lexuarit të tij për të ngjizur më tej produktin e publikuar; ato mund të shqyrtohen si produkte që janë përftuar duke bartur edhe këtë tharm);

së katërti, përgjithësisht kategoritë e ndryshme tekstore, edhe ato që luajnë rolin ndërmjetësues mes veprës dhe lexuesit (*parafjalë, parathënie, fjalë e editorit, esë, preambul,...*), brenda funksionit të tyre, shfaqin liri ngjizjeje që mundësohet pikërisht nga roli i *ndërmjetësuesit*, që nuk e fsheh synimin pohues, entuziast, madje edhe subjektiv në raport me produktin që paraqet e “servir”, liri që i mundëson njëherazi edhe përzgjedhjet ligjërimore, që priren nga figurshmëria në të shprehur, e jo pak herë edhe literariteti i mesazhit (kategoritë e mësipërme tekstore të lëvruara nga Kuteli të orientojnë të gjuhë mbështetje teorike në ligjësitë e përfutimit të këtyre modeleve);

më së fundi, na duhet të theksojmë se përballë tekstit shqyrtues që si synim parësor ka të studiojë, interpretojë a vlerësojë një tekst a tekste letrare, gjendemi pandalshëm përballë një problemi njëherazi ontologjik e epistemologjik që qysh në thellësi të shekujve, qysh me Platonin e më tej me Aristotelin e deri në ditët tona ka shqetësuar dhe angazhuar më së shumti studiues të letërsisë, por po aq edhe filozofë, eruditë, shkrimtarë, gjuhëtarë, estetë, semioticienë, etj., të cilëve teksti letrar u interesonte drejtpërdrejt, ndaj e analizonin atë edhe si strukturë, duke u përkujdesur të zbulonin e përshkruanin arkitekturën e tij dhe mjetet a lëndën e përfutimit të tij; por edhe të tillë që e rroknin atë si vlerë e raport me botën e shoqërinë, ngaqë i interesonin më së pari *mesazhet* që barteshin në të, më shumë se *natyra e ngjizjeve ligjërimore* që atë e kishin përvijuar (te shqyrtimet e Kutelit është e dukshme kjo prirje e dytë, edhe pse nuk mungon përkujdesja dhe kompetenca për të shqyrtuar natyrën e ngjizjeve ligjërimore të veprave të analizuar; madje në jo pak raste, me një aparat teoriko-letrar e koncepte nga më funksionalelet për kohën).

Dy qoka orientuese përgjatë shqyrtimit

Në këtë kontekst, qasja jonë përvijohet e mbështetur në këto dy qoka interpretuese:

së pari, jetëgjatësinë e shqyrtimeve e interpretimeve të tij kritike e vështrojmë të lidhur ngushtë me natyrën e kahjes teorike që është në bazë të shqyrtimeve të tij, që sipas nesh përafrohet me atë të *kritikës shpjeguese a diturore*.

Mendimi kritik letrar i tij mund të integrohet në hullitë e *kritikës shpjeguese a diturore*, me fillesa në periudhën kur Kuteli nisi të lëvrojë këto kategori tekstore, një kritikë që vijoi të lëvrohet në kohë, të thellohet e zgjerohet në koncepte e metodologji, pavarësisht nga lindja e zhvillimi i këndvështrimeve e metodave të ndryshme kritike në ato dhjetëvjeçarë; një kritikë që sot integrohet natyrshëm e me lehtësi në problematikën që parakupton *autorin, tekstin, lexuesin, thënjepërfutuesit dhe receptuesit a thëniemarrësit*. Është *kritika shpjeguese diturore* që sipas tipologjisë së vendosur nga Albert Thibaudet në veprën e tij “Physiologie de la critique” (1930) (shih gjithashtu, Thibaudet, A. 1939, 2007; Leymarie, M. 2006; Tanguay, D. 2011) “përshtat pikëpamje të ndryshme dhe ndonjëherë të kundërta mbi tekstin letrar; është kritikë që mund të mbiquhet njëherazi “e ‘jashtme’ ose ‘e brendshme’, sipas rastit nëse ajo e vë theksin mbi gjenezën e veprave dhe mbi recepsionin e tyre e po ashtu të strukturave të tyre” (Maurel, A. 1994:3).²

së dyti, për të shpjeguar veçantitë e ngjizjes dhe receptimit të kategorive tekstore të përfuara në përvojat shqyrtuese të Kutelit, në ndihmë na vjen koncepti i *infratekst/ përtejtetit* a i *tekstit të lexuesit* të tekstit letrar.³ Ky koncept karakterizohet në nivel teorik nga një ndryshim i

² Për këtë argument jemi shprehur më gjerë në kumtesën tonë “Edhe një qasje drejt eseve kritike të M. Kutelit”, mbajtur në Konferencë shkencore “Mitrush Kuteli në 110-vjetorin e lindjes, 26 maj 2017, organizuar nga Universiteti “Fan Noli”, Korçë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Institutin Albanologjik të Prishtinës, Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

³ Janë të shumta quajtjet a emërtimet që i vijnë përreth idesë së *infratekst/ përtejtetit* a *tekstit të lexuesit* të tekstit letrar ose që parakuptojnë përfshirjen a nënshkrimin e subjektit në të lexuar: *autografi, kreolizim i të lexuarit, kritikë krijuese, infratekst, lexim-shkrim, lexim eseistik, poemë kritike, poetikë e të lexuarit, rishkrimësi, tekst i të lexuarit, tekst i imagjinuar, tekst i rifiguruar, tekst i veçanësisë* – pa harruar në këtë rast po aq shprehje të përdorura, mes të tjerave, për të shprehur në mënyrë të përshtatshme çdo përmasë të epërme të subjektivitetit

paradigmës, që përftohet “nga kalimi i një konceptimi të të lexuarit letrar të përfshirë në një teori të tekstit, që e parakupton lexuesin implicite ose virtual (e thënë ndryshe në perspektivën e teoricienëve të recepsionit), në një konceptim të të lexuarit letrar që parakupton dhe interesohet për rikonfigurimin e tekstit nga lexuesi real dhe paraqet mënyra të shumëfishta realizimi. Ka pra një zhvendosje të interesit: prej lexuesit virtual në lexuesin real, dhe, për pasojë, prej “tekstit të veprës” në “tekstin e lexuesit” (shih Rouxel A. në Langlade, G. 2004:4-5).

Nocioni i *infratekstit/përtejtekstit a tekstit të lexuesit* të tekstit letrar nuk shfaqet i lidhur vetëm me teorinë e letërsisë. Ai çon më gjerë në një mënyrë trajtimi bashkëkohore të letërsisë dhe artit që merr parasysh më shumë ndjesitë e lexuesit ose spektatorit sesa aftësinë e tij kritike; më shumë lidhjen, aftësinë, kompetencën estetike se qëndrimin hermeneutik. Shqyrtimet kritike të Kutelit janë modele tejet domethënëse në të cilat spikatin këta tregues, madje të një *infrateksti a përtejteksti* të përftuar nga një lexues që zotëron në nivele sipërore edhe aftësinë kritike e hermeneutike, krahas kompetencës leximore, ndjesive e qëndrimeve estetike.

Infrateksti/Përtejteksti a Teksti i lexuesit

Por ç’është teksti i të lexuarit/lexuesit të tekstit letrar sipas trajtimeve bashkëkohore mbi aktualitetin krijues të lexuesve?

Në trajtesat e studiuesve që po përpunojnë ndërkohë konturet e kësaj “kategorie tekstore” theksohet se përpjekja për të përftuar *infratekset a përtejtekset* e integron të lexuarit dhe përvojat e të lexuarit në larminë e konteksteve, kulturave dhe proceseve imagjinare, duke rinovuar mënyrën e trajtimit kritik të veprave; këto produkte të përftuara mund të shqyrtohen si të tilla në një perspektivë ndërdisiplinore; përftimi i tyre shfaqet në përpunimin e teksteve të lexuesve në sfida të natyrës individuale e sociale; procesi i përfimit të tyre përvijon një teksturë a thurimë të asaj që tekstualizohet në marrëdhënien dyjare të lëvizshme dhe të pasigurtë që ndan dhe rilidh njëherazi lexuesin me veprën; vetë brendia e *infrateksteve/ përtejteksteve* ushqehet e përftohet prej materiali a lënde natyrash të ndryshme: formacione verbale, ritme, melodikë tingujsh, ngjyrash a ngjyrimesh, formash dhe imazhesh, copëzash fantazmike dhe ëndrrash; produkti si i tillë “është një mënyrë e nderimit e vlerësimit, një mënyrë e të bërit homazh faktit që jeta gjithnjë e gjallë e në lëvizje e veprave të mëdha

në një tekst ose të situatës së atij që e takon atë (shih më gjerë, Mauzanic, C. 2011:13-14).

i bën ato të afta t'u përshtaten konteksteve të shumëfishta a të larmishme; është një mënyrë për t'u folur subjekteve të ndryshme një gjuhë që ato mund ta kuptojnë"; ai produkt përftohet natyrshëm në procesin e të lexuarit të të gjithë ata që janë të ndjeshëm në lidhje me subjektivitetin që paraprin në aktin e të lexuarit dhe mënyrën me të cilën ky i nënshtrohet vetvetishëm personalitetit të atij që e përmbush, lidhur ngushtë me situatën e tij historike dhe sociale; ai shfaqet veçanërisht i dukshëm te ata që punojnë në fushën e psikanalizës për të cilët vendi i subjektit në takimin me formacionet estetike është përcaktues (shih më gjerë, Mazauric, C. etj. (dir.), 2011).

Në këtë mënyrë, sipas pikëvështrimit që ka të bëjë me *infratekstin/përtejtekstin a tekstin e lexuesit*, të lexuarit letrar vërehet si një aktivitet përftues a prodhues i kuptimit, i mbështetur mbi një lidhje mes dy poleve, tekstit auktorial dhe përvijimit të të lexuarit, i pari që ruan përtej parakohësisë së tij vlerën e referencës. Ndërkohë që nëse të lexuarit do të mund të cilësohet vërtet letrar, duhet që përvijimi i këtij procesi të materializohet në një *kundër-tekst*, që do ta quanim *tekst të të lexuarit* që të mund ta kuptojmë njëherazi nën formën e tij të prekshme dhe në tërësinë e tij të veçantë e përgjithësuese" (Trouvé, A. 2011:31-32).

Ndryshon ky proces i të lexuarit i tekstit letrar, nga procesi i komunikimit të mesazheve shkencore, i vlerësimit a përvetësimit të tyre në kontekstin e të lexuarit të veprës shkencore.

Le të vërejmë kalimthi se për veprat shkencore përftohet një proces tjetër lexueshmërie; veprat shkencore nuk synojnë drejtpërdrejt e në mënyrë të menjëhershme një lexues të gjerë; ato përftohen si tekste që u adresohen lexuesve pas përfutimit të një taksonimie që është e pranishme natyrshëm në mendjen e autorit kur shkruan, një renditje hierarkike a shkallëzim që parakupton ndërveprimin e lexuesve: lexuesit e "rreshtit të parë", të cilëve autori u drejtohet më së pari, ai i konsideron më pranë tij e veprës së tij; pothuaj bashkëkrijues të kuptimeve në procesin e të lexuarit; e ndaj mesazhet strukturohen në një mënyrë të veçantë për këtë destinacion.

Po ashtu veprat shkencore "energjinë" fillestare e kanë të destinuar për një bashkësi lexuesish a individësh që janë njohës më të drejtpërdrejtë të problematikës së shqyrtuar, për studiuesit e lëvruarit e të njëjtave objekte studimi, të dukurve e teorive që synojnë problematikë të përafërt (të cilët e përthithin dhe e interpretojnë informacionin e dijen e përçar në përmasat e dhura e të lakmueshme).

Kjo veçanësi është ngjizur në prani të një situatë paraprake tejet specifike që ekziston në komunitetin shkencor: transmetimi i informacionit dhe dijes, më shumë se në çdo sferë tjetër komunikimi nuk është thjesht linear, nga një transmetues A, në një pritës mesazhi B, por është një proces i njëkohshëm kuptimësimi dhe rikuptimësimi në vijimësi mes “interpretëve” A dhe B, që paprerë ndërrojnë rolet në dhënës e marrës informacioni e interpretues të tij, ndërtojnë së bashku kuptimet, në një kontekst dijeje ku e njohura nxit reflektime për të zgjeruar hapësirën e zotërimit drejt të panjohurave; dhe të panjohurat bëhen gjithnjë e më të dukshme, pikërisht se zgjerohen hapësirat e së njohurës.

Madje në këtë komunitet studiuesish ekziston paraprakisht një lloj bashkëmarrëdhënieje, një lloj komunikimi i pamaterializuar në shprehje, që përftohet thjesht përmes përkujdesjes së njëkohshme për njohje ndaj objektit të studimit të përbashkët në shqyrtim ; ky objekt i përbashkët a i përafërt studimi është, në një kuptim, si një pasqyrë që reflekton pamjen e të gjithë atyre që i qasen asaj, pavarësisht nga profilet që shfaqin, nga pikëvështrimet a vendndodhja në lidhje me të; është një komunikim që mund të quhet *i pashenjuar/par défaut*, mes autorit të veprës dhe bashkësisë së individëve që janë drejtpërdrejt njohës dhe të interesuar për problematikën e shqyrtuar; komunikim individësh që enden e kërkojnë në të njëjtat hapësira, shqyrtojnë e teorizojnë mbi një problematikë të ngjashme a të përafërt, që njohin trajtesat e njëri-tjetrit, e ndaj edhe janë në bashkëmarrëdhënie të vazhdueshme, pa pasur nevojën e adresimit të mesazheve ndaj njëri-tjetrit; që përjetojnë shqetësime intelektuale, ankthe e ngazëllime gati të njëjta përballë problemeve të shfaqura e zgjidhjeve të mundshme (shih më gjerë, Plangarica, T., 2016:9-12).

Sipas studiuesve të sotëm të procesit të të lexuarit dhe, duke u nisur prej kriterëve të përcaktuara prej tyre, mundet të përvijojmë një shkallëzim në pesë shkallë, prej të cilave vetëm tri nxjerrin në pah tekstin e të lexuarit të tekstit letrar.

Shkalla e parë, oralizimi i tekstit të lexuar (ta thuash me gojë, të flasësh me gojë për të – le të kujtojmë në këtë rast ‘kritikën e salloneve’, si praktikë leximore sidomos në shekullin XIX).

Shkalla e dytë, kritikë e shkruar, pak a shumë diturore, institucionale ose gazetareske.

Shkalla e tretë, përftimi i tekstit të të lexuarit letrar bashkëkohor që përftohet në një lëvizje të dyfishtë prej analizës dhe sintezës në ndërveprimin e akteve të të kuptuarit dhe emocioneve të nxitura prej efektit estetik.

Më së fundi, duke e kapërcyer procesin e përfimit të një produkti, në formën e *përtejtekstit* a *infratekstit*, na shfaqen si produkte të një natyre tjetër edhe dy “kategori” në dy shkallë të tjera:

Shkalla e katërt, tekstet letrare të përfuara nga “endja në tekstet e mëdha të letërsisë; një tekst i tillë i autorit të veçantë pushon së qeni poli parësor i referencës për t’u bërë pretekst për një trajtim që e përfshin dhe e tejkalon atë (le të kujtojmë përvojat shkrimore të Prustit, Montaigne-it, etj.).

Shkalla e pestë, tejkallim tjetër i të lexuarit letrar është ai i rishkrimit të një thurime, endjeje të tekstit, në veçanti e rrëfyer, rishkrim që njeh një lloj suksesi në kritikën universitare” (shih më gjerë, Trouvé, A. 2011:35).

Shqyrtimet kritike të M. Kutelit si infratekste a përtej tekste të tekstit letrar

Mund të integrojmë natyrshëm në këto shkallë tashmë korpusin e mendimit kritik të Kutelit, të pasikletosur nga kallëpet hera-herës të parehatshme që na imponojnë përkatësinë në këtë ose atë kategori tekstore, a në këtë apo atë shkollë a kahje të kritikës; e po ashtu, kemi hapësirën e duhur për të integruar aty edhe përvojën e shkëlqyer të tij me “Tregimet e moçme shqiptare”, si formë e asaj thurime që u përftua si nxitje e përftuar nga monumente të prozës popullore shqipe, në një kontekst të caktuar psiko-intelektual, vetjak e social.

Ky pozicionim i yni në shqyrtimin e *përtejtekstit/pastekstit/tekstit të lexuesit* na mundëson t’i shmangemi dy rreziqeve të hermeneutikës të marrë në kuptimin e ngushtë të fjalës, që synon dekodimin korrekt të një kuptimi të ngulitur nga një synim auktorial, por të shihet ajo si një proces që parakupton të dy polet, të autorit dhe lexuesit.

Ky pikëvështrim a kjo qasje në lidhje me *përtejtekstin/pastekstin a tekstin e lexuesit* na mundëson ta shohim atë si “replikë ndaj tekstit të autorit që futet e përfshihet në një shkëmbim të gjerë dhe që nuk do të duhet të mëtojë objektivitetin e shkencave ekzakte; në mënyrën e tij ai është një aventurë e vazhdueshme e kuptimit, bartës nga ana e tij e Inkoshientit, i të pavetëdijshmes leximore [...] është një lloj *shkrimësie* që përvijohet në një teori të shkallëve të fiksionit: shkalla I: fiksioni si botë alternative ndaj botës reale; shkalla II: fiksioni si pjesë imagjinare që shkakton e nxit çdo thënie e drejtuar kah njohja, e në veçanti thënia poetike; shkalla III e metatekstit e quajtur ndërkohë të lexuarit letrar...” (Trouvé, A. 2011: 38-39).

Vështrimi i "Shënimeve kritike" të Kutelit na çon natyrshëm në hapësirat e shkallës së dytë e të tretë të fiksonit të përmendur më lart; por nga ana tjetër, ky lloj shkallëzimi na ndihmon të shqyrtojmë jo pak në lidhje me veçantitë e opusit të tij kritik.⁴

Në mbyllje

Është ky pikëvështrim një ndër çelësat që mund të na ndihmojë të zbërthejmë teknikat dhe procedetë e pranishme në "shënime kritike" të Kutelit, ku ngërthehen me virtuozyt ndjesitë dhe efektet e nxitura nga të lexuarit e tekstit poetik, me shqyrtimin e materies/lëndës a mjeteve gjuhësore të ngjizjes së tyre. Dijet enciklopedike të gjera e të thella të studiuesit, ndërdisiplinore në brendi e shfaqje, por me përqendrim në ato letrare, retorike, poetike e stilistike, veçse ndihmojnë më tej që ky ngërthim të jetë i suksesshëm dhe teksti i përfutur të jetë i motivueshëm.

BIBLIOGRAFI

- Kuteli, M. (2007), *Shënime kritike*, Shtëpia Botuese GrandPrind, Tiranë.
Langlade, G., (2004), *Le sujet lecteur auteur de la singularité de l'œuvre*, në A. Rouxel, G.
Langlade (dir.) *Le sujet lecteur. Lecture subjective et enseignement de la littérature*, Rennes, Presses Universitaires de Rennes.
Leymarie, M., (2006), *Albert Thibaudet, "l'outsider du dedans"*, Presses Universitaires du Septentrion.
Maurel, A. (1994), *La Critique*, Hachette Supérieur.
Mazauric, C., Fourtanier, M-J., Langlade, G., (dir.), 2011, *Le texte du lecteur*, Vol.2, TheoCrit'n.2, P.I.E. Peter LANG.
Plangarica, T., (2016), *Parafjalë për vepra dhe autorë*, Onufri.

⁴ Na e bëri edhe më të motivueshme qasjen tonë studimi i thelluar i prof. dr. A. Plasarit, që shoqëron korpusin e mendimit kritik të M. Kutelit, botuar i plotë në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së Kutelit, studim që na thelloi besimin në tezën që kritika e kritikës së tekstit letrar gjeneron në vijimësi vlera (në kushte të caktuara, sigurisht); dhe, kur teksti pronësohet nga një lexues që zotëron kompetencat e leximit të tekstit letrar, gjenerohen në vijimësi metatekste që përngjasojnë me *përtejtektet* a *tektet e të lexuarit* të tekstit letrar. Për më tepër, studimi i A. Plasarit duket se e lehtëson disi pengun e Kutelit për *moskuptimin e mesazheve të tij*, duke i shtuar edhe një përmasë tjetër atyre mesazheve: si modele të *përtejtektit*, që përlindin në vijimësi simotra të tyre për nga mënyra e ngjizjes.

- Plasari, A. (2007), *Shënime për Shënimet e Mitrush Kutelit*, në M. Kuteli, *Shënime kritike*, Shtëpia Botuese GrandPrind, Tiranë.
- Tanguay, Daniel, (2011), *Albert Thibaudet ou le promeneur magnifique*, në *Argument*, vol. 13, n.1, Automne 2010-Hiver 2011.
- Trouvé, A., (2011), Le texte de lecture comme texte du lecteur, në Mazaucic, C., Fourtanier, M-J., Langlade, G., (dir.), 2011, *Le texte du lecteur*, Vol.2, TheoCrit'n.2, P.I.E. Peter LANG.
- Thibaudet, A., (1930), *Physiologie de la critique*, Librairie Nizet, s.d.
- Thibaudet, A., (1939), *Réflexions sur la critique littéraire*, Gallimard, 1939.
- Thibaudet, A., (2007) *Réflexions sur la littérature*, Paris, Gallimard; Collection "Quarto".